

VENDIM
Nr. 17, datë 26.11.2009

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT
TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 114 pika 3 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Pirro Xhixho zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)